

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SHBA-ja fton Putinin në samitin e G20-ës në Majami
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/bota/shba-ja-e-ka-ftuar-putinin-ne-samitin-e-g20-es-ne-majami-i1185748
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 07:23:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 07:17:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	94102b12755f5104e8b54824ff1bec1bd9f56f29c78043d517cd18e263ac36f4
TEKSTI	9bdd5c426f034ffd7b41c3bc4959792865764fcea9bbdeb3d1437956ef6e873d
PAMJA	6eb9f4d8a311644c976c7f44bb8ee73d8330c43fac101701b74917b5e80a82f0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	dc3ef40c7859a6d832fa2463aa785a7731b39e7ac64a4f6cd8052cbe7d3b5778
E MËPARSHMJA	496c74e6b3042f79219b574391881273eae0057aa6df21cda7edb9452b176bf1
RRËNJA MERKLE	9a6b20a4f7bca7d38b85ed38d229f05609a1ca606edde02ba3c9e62d673a221c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/dc3ef40c7859a6d832fa2463aa785a7731b39e7ac64a4f6cd8052cbe7d3b5778>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SHBA-ja fton Putinin në samitin e G20-ës në Majami



Nga A2 CNN

24 Shtator 2026, 09:17 | Bota



Shtetet e Bashkuara e kanë ftuar presidentin e Rusisë, Vladimir Putin, të marrë pjesë në samitin e Grupit të 20 ekonomive më të mëdha të botës (G20), që do të mbahet në Majami në dhjetor, tha të mërkurën sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio.

Administrata e presidentit Donald Trump është duke kërkuar mënyra për t'u zbutur luftimet në Ukrainë.

"E kemi ftuar presidentin Putin në [takimin e] G20-ës", u tha Rubio gazetarëve pas takimit me ministrin e Jashtëm rus, Sergei Lavrov, në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork.

"Mendojmë se kjo është një mundësi që ai të angazhohet jo vetëm me presidentin [Trump], por edhe me liderë të tjerë botërorë", theksoi Rubio, përcjell A2.

Kjo ftesë përbën konfirmimin e parë publik se Uashingtoni e ka ftuar Putinin në samitin e liderëve të G20-ës. Zyrarët rusë më parë janë ftuar në takime të nivelit ministror.

Rubio tha se samiti mund të krijojë mundësi që Putini dhe presidenti Donald Trump të takohen. Më vonë, ai u bëri të qartë gazetarëve se nuk ka ndonjë marrëveshje për takim.

Dy liderët kanë biseduar disa herë në telefon qëkurse Trump u rizgjodh në vitin 2025, por Rubio tha se një takim ballë për ballë do të ishte më i dobishëm nëse do të kishte rezultat të përcaktuar qartë.

Para takimit Rubio-Lavrov, zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha se nevojitet punë përgatitore para ndonjë takimi mes Trumpit dhe Putinit.

Rubio tha se pas vendimit të Trumpit për ta ftuar Putinin qëndrona gatishmëria e tij për t'u takuar me kundërshtarët.

"Presidenti i Shteteve të Bashkuara, ky president, është i gatshëm të angazhohet dhe të takohet me pothuajse këdo", tha ai.

"Nëse takohesh vetëm me njerëz me të cilët pajtohesh, atëherë këto janë takime shumë të këndshme, por asgjë nuk ndodh", shtoi Rubio. "Për t'i zgjidhur problemet, duhet të takohesh me njerëz me të cilët nuk pajtohesh".

Por Rubio paralajmëroi se ftesa nuk duhet të shihet si dëshmi se një takim mes liderëve apo një marrëveshje më e gjerë është afër të ndodhë.

Armëpushim i propozuar për energjinë

Rubio e bëri këtë njoftim në kohën kur Uashingtoni po i bënte gjithashtu trysni Moskës dhe Kievit për ta shqyrtuar një armëpushim të kufizuar lidhur me sulmet ndaj infrastrukturës

TE FUNDIT

Avioni britanik rrëzohet pranë banesave

Dy operacione në Tiranë e Krujë, arrestohen 2 persona, sekuestrohen armë, kapsolla elektrike dhe municion luftarak

Vlora Hyseni përballlet sot me GJKKO

🔴 "Mesnata sjell rreshe shiu", zbuloni zonat që do të preken

MË TË VIZITUARAT

Sot në Kuvend interpelancë me Jaupajn dhe Kumbaron, diskutohet dhe misioni us...

Nuk u mbijetoi plagëve të marra nga goditja me thikë, ndërron jetë në spital ...

Porositë pas arrestimit të Hysenit, Berisha drejtuesve të PD: Reagim politik ...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

energjetike dhe, mbase, objektivave që lidhen me grurin.

Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka bërë thirrje për ndalimin e sulmeve ndaj objekteve energjetike. Pas takimit me Trumpin në Nju Jork të martën, Zelensky tha se Kiev i ishte gatshëm t'i ndalte sulmet e tilla, nëse Rusia do ta bënte të njëjtën gjë. Reuters raportoi se një mirëkuptim i mëparshëm për objektivat energjetike dështoi shpejt pasi sulmet rifilluan.

Rubio tha se propozimi ishte diskutuar në kontaktet e fundit të SHBA-së me të dyja palët, përfshirë nga i dërguari amerikan, Steve Witkoff, dhe këshilltari presidencial Jared Kushner.

Sekretari i Shtetit theksoi se një armëpushim për energjinë nuk do të përbënte marrëveshje për paqe.

"Kjo nuk e zgjidh luftën", tha Rubio, por argumentoi se ai mund t'i kufizojë disa nga pasojat e konfliktit dhe të krijonte një bazë të mundshme për negociata më të gjera.

"Në fund të fundit, të gjithë duam që kjo luftë të përfundojë", shtoi ai.

Kur u pyet përse Uashingtoni po i kërkonte Ukrainës të ndalte sulmet ndaj objekteve energjetike ruse, pavarësisht sulmeve ruse ndër vite ndaj rrjetit elektrik të Ukrainës, Rubio pranoi se objektivat shërbejnë për qëllime të ndryshme.

"Kur bëhet fjalë për energjinë në anën ruse, sulmet energjetike me të cilat po përballen kanë në shënjestër rafineritë dhe objektet e naftës dhe gazit", tha ai. "Për palën ukrainase, energjia nënkupton rrjetin e tyre elektrik".

Rubio tha se sulmet ukrainase ndaj infrastrukturës së naftës ruse synojnë të ulin të ardhurat e Moskës, ndërsa sulmet ruse ndaj rrjetit elektrik të Ukrainës ndikojnë drejtpërdrejt në furnizimin me energji elektrike dhe shërbime të tjera bazike.

Ky dallim, tha ai, e bënte më të vështirë arritjen e një marrëveshjeje, por nuk e bënte atë më pak të vlefshme. "Prandaj, nuk është e lehtë që brenda natës të thuash: le ta arrijmë një marrëveshje", tha Rubio. "Por mendoj se ia vlen të besh përpjekje për ta bërë të mundur këtë".

Kievi ka shtuar sulmet ndaj objekteve ruse të naftës javët e fundit, ndërsa Rusia ka vazhduar sulmet ndaj infrastrukturës energjetike të Ukrainës.

Takimi me Lavrovin nuk sjell përparim

Rubio dha pak hollësi për takimin e tij me ministrin e Jashtëm Lavrov dhe nuk njoftoi për ndonjë përparim.

Departamenti amerikan i Shtetit tha se të dy diskutuan luftën në Ukrainë dhe marrëdhëniet SHBA-Rusi. Takimi u zhvillua pasi Uashingtoni po përpiqet t'i mbajë të hapura kanalet diplomatike, duke testuar nëse Moska dhe Kiev mund të bien dakord për masa të kufizuara për uljen e luftimeve.

Kremlini ka thënë se aktualisht nuk ekzistojnë kushtet për kalimin në negociata formale për paqe, ndërsa ka thënë gjithashtu se Putini mbetet i hapur për kontakte me Trumpin.

Rubio paralajmëroi gjithashtu se konflikti mund të përhapet përtej Ukrainës përmes sabotimit, sulmeve hibride ose një incidenti që përfshin forcat ushtarake.

"Një nga shqetësimet që kemi, ndër shumë të tjera, lidhur me luftën mes Rusisë dhe Ukrainës është se ajo mund të përhapet në vende të tjera", tha ai.

Ai përmendi mundësinë e një sulmi hibrid ose sabotimi, apo të një incidenti që përfshin avionë ushtarakë.

"Ajo mund të përhapet diku tjetër, qoftë përmes një sulmi hibrid, një sulmi sabotimi apo një keqkuptimi", tha Rubio.

Ai tha se Uashingtoni i ka ngritur këto shqetësime me qeveritë evropiane, mes frikës në rritje se lufta mund të krijojë pika të reja tensioni jashtë Ukrainës. / **REL (A2 Televizion)**

MUND TE LEXO NI GJITHASHTU



"Ne jemi viktimat!" Pezeshkian tregon në OKB fotot e fëmijëve iranianë të vrarë. SHBA largohet nga salla



Evropa shqyrton plane emergjente pas provokimeve ruse dhe paralajmërimeve për sulm të mundshëm



8 viktimat nga sulmet ruse në Ukrainë gjatë fjalës së Zelenskyt në OKB, dron i parë i paidentifikuar në aeroportin e Berlinit



CIA jep alarmin: Rusia po përgatit sulme me dronë ndaj Italisë, Spanjës dhe Francës



"Duhet të jemi partnerë jo kundërshtarë", Xi nis vizitën në SHBA, mirëpritet nga Trump



Alarmi i studiuesve: El Niño dhe valët ekstreme të të nxehtit mund të shkaktojnë 451 mijë vdekje deri në shkurt

Latest Videos





Masat e GJKKO, sot seanca për Embro Sulejmanin dhe Fatjon Kallucin, në mesditë paraqitet Vlora Hyseni



"Sallatë me makarona" nga shefi i kuzhinës Krenar Beshiri



"Rruga e Elbasanit me trafik të rënduar", zbuloni rrugët që duhen shmangur në Tiranë



"Mesnata sjell rrebeshe shiu", zbuloni zonat që do të preken

Shqipëria

Aktualitet

Kronikë

Politikë

Ekonomi

Sociale

Kulturë

Moti

Kosova

Kulturë

Sociale

Ekonomi

Politikë

Kronikë

Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani

Bota

Argëtim

Showbiz

Lifestyle

Kapur në kamera

Teknologji

Sport

Live Euro 2024

Futboll

Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta

A2 CNN në Izrael

31 Minuta

A2 CNN në Ukrainë

Lumi i kokainës

Ditari ndërkombëtar

Zbulo

Imagjinatë

Dëshmi

Facebook

Twitter

Instagram

YouTube

A2 CNN LOGO

Live TV

Rreth nesh

Kushtet e Privatësisë

Karriera

Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk

All Rights Reserved.

Mundësiuar nga Mediaset

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.